

DEKRET
Nr.265, datë 21.7.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.7393, DATË 12.6.1990 "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE PËR JASHTË SHTETIT DHE DHËNIEN E VIZAVE"

Në mbështetje të nenit 28 pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave

DEKRETOJ:

Neni 1

Në nenin 17 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Shtetasit e shteteve anëtare të Komunitetit Ekonomik Evropian, të shteteve të EFTA-s, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë, Turqisë dhe Bullgarisë kanë të drejtë të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë pa qenë nevoja për t'u pajisur me vizë".

Neni 2

Në nenin 18 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Shtetasit e shteteve anëtare të Komunitetit Ekonomik Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Turqisë dhe Bullgarisë paguajnë një taksë për hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë, masa e së cilës përcaktohet me dispozita të veçanta".

Neni 3

Në nenin 19 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Organet kompetente kanë të drejtë të ndalojnë hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të personave që konsiderohen të padëshirueshëm (persona non grata)".

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha